



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

THIRRJE PËR APLIKIM

Përkrahje me

- 1. Set për nevoja të bletarëve,**
- 2. Centrifuga elektrike për nxjerrjen e mjaltit**

(Subvencione ne kuadër te sektorit te Bletarisë)

Gjakovë, Maj 2025

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 10 dhe 14 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës me Nr. 01/110-01-3560 të datës 04.02.2020, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) :

Njofton bletaret e Komunës së Gjakovës, që mund të aplikojnë për skemën e subvencioneve të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për mbështetjen e tyre me:

- **Centrifuga elektrike për nxjerrjen e mjaltit dhe**
- **Set për nevoja të bletarit** (vaske për nxjerrje të mjaltës depozitues mjalti 50kg, tymuese, doreza për bletare, kapëse dhe çelës për hapje të kornizave, brusha druri, bluza dhe kapele, site me dy shtresa dhe pirun për zhvulosjen e kornizave)

Kriteret e pranueshmërisë :

- Ndarja proporcionale sipas rajoneve – pesë (5) rajone;
- Fermeret femra, minoritetet dhe të rinjtë kanë përparësi;
- Përfituesit duhet të bashkë financojnë vlerën e subvencionit minimum 20%;
- Aplikuesit të mos jenë përfitues të Subvencioneve nga Komuna nga viti paraprak dhe viti aktual;
- Përparësi kanë bletaret që nuk kanë përfituar gjatë viteve të fundit;
- Aplikuesi duhet të jetë banor i Komunës së Gjakovës;
- Bletari duhet të aplikojë vetëm për një pajisje;
- Të jete aplikues në Pagesa Direkte në kuadër të MBPZHR-se (për vitin 2025);
- Aplikuesit duhet të kenë të shënuar në çdo koshë në bletishten e tyre numrin identifikues të fermerit - NIF sipas standardit;
- Aplikuesit për pajisje të bletarisë duhet të kenë së paku 30 koshere bletësh të aplikuar në Pagesa Direkte në kuadër të MBPZHR-se (për vitin 2025);

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Numri identifikues i fermerit (NIF - kopje);
- Vërtetimi i tatimit në pronë;
- Dëshmia e Aplikimit në Pagesa Direkte 2025 (Formulari i Aplikimit);
- Deklarata në betim.

Fletë aplikacioni tërhiqet në zyrat e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) të Komunës së Gjakovës.

Afati i aplikimit: **12.05.2025 deri me 26.05.2025**